



USHTRIA



Viti i 79-të i botimit Nr. 3 (827959)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 23 janar 2026



105 VITE ARMA E XHENIOS

Një shekull shërbim, sakrificë dhe rindërtim për Shqipërinë

» faqe 6



KUNDËRADMIRAL ARSEN MULLAJ MERR DETYRËN E KOMANDANTIT TË FORCËS DETARE, MINISTRI VENÇU: MODERNIZIMI, PRIORITET STRATEGJIK I QEVERISË

Në një ceremoni të posaçme ushtarake, kundëradmiral Arsen Mullaj mori zyrtarisht detyrën e komandantit të Forcës Detare, pas dekretimit nga Presidenti i Republikës. Ai zëvendëson në këtë funksion nënadmiralet Adnan Aga, i cili përfundoi mandatin e tij në krye të Forcës Detare. Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes, Piro Vengu, theksoi se zhvillimi dhe modernizimi i Forcës Detare ...

faqe 2



SHSHPPFA, GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI MORI PJESË NË TAKIMIN E KOMITETIT USHTARAK TË NATO-s

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral lejtënant Arben Kingji, mori pjesë në ditën e parë të takimit të Komitetit Ushtarak të Shefave të Shtabeve të vendeve anëtare të NATO-s, ku u zhvilluan diskutime të rëndësishme mbi mbrojtjen kolektive dhe sfidat aktuale të sigurisë. Gjatë punimeve, vëmendja u përqendrua në vlerësimin e mjedisit të sigurisë, rritjen e aftësive...

faqe 4



SHQIPËRIA NË ZEMËR TË PARISIT: NJË MBRËMJE KULTURORE QË BASHKOI DIPLOMACINË, ARTIN DHE MIQËSINË FRANKO-SHQIPTARE

Në një nga hapësirat më prestigjioze kulturore të kryeqytetit francez, Teatri i Aleancës Franceze në zemër të Parisit, u zhvillua një mbrëmje e veçantë kushtuar Shqipërisë, e organizuar nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Francë, në bashkëpunim me televizionin ndërkombëtar TV5 Monde. Ky aktivitet i rëndësishëm kulturor dhe diplomatik shënoi një moment...

faqe 10

Shqipëria dhe Belgjika forcojnë partneritetin ushtarak për siguri rajonale

Ministri i Mbrojtjes, **Pirro Vengu**, priti në takim homologun e tij belg, **Theo Francken**, i cili zhvilloi një vizitë zyrtare në kryeqytet.

Gjatë takimit, dy ministrat diskutuan mbi forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe në fushën e mbrojtjes, me fokus të veçantë në stërvitjet e përbashkëta, rritjen e ndërveprimit operacional dhe zhvillimin e bashkëpunimit në industrinë e mbrojtjes. Sipas tyre, këto elemente janë thelbësore për rritjen e kapaciteteve mbrojtëse dhe për forcimin e sigurisë rajonale.

Ministri Vengu vlerësoi partneritetin me Belgjikën dhe rolin e saj si aleate e besueshme në kuadër të NATO-s, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit me vendet mike dhe aleate: “Kënaqësi të prisja në Tiranë homologun belg Theo Francken, një mik i vyer i vendit tonë. Me Belgjikën po punojmë për të thelluar bashkëpunimin në stërvitje të përbashkëta, ndërveprim operacional dhe industrinë e mbrojtjes, si pjesë e përpjekjes për të rritur kapacitetet tona dhe sigurinë rajonale”, - u shpreh ministri Vengu.

Në këtë takim u ritheksua se **thellimi i partneritetit me aleatët mbetet një prioritet strategjik për Shqipërinë**, në funksion të stabilitetit, sigurisë rajonale dhe perspektivës europiane të vendit.



Kundëradmiral Arsen Mullaj merr detyrën e Komandantit të Forcës Detare, ministri Vengu: Modernizimi, prioritet strategjik i qeverisë

Në një ceremoni të posaçme ushtarake, **kundëradmiral Arsen Mullaj** mori zyrtarisht detyrën e komandantit të **Forcës Detare**, pas dekretimit nga Presidenti i Republikës. Ai zëvendëson në këtë funksion **nënadmiral Adnand Agastra**, i cili përfundoi mandatin e tij në krye të Forcës Detare.

Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes, **Pirro Vengu**, theksoi se zhvillimi dhe modernizimi i Forcës Detare përbën një përparësi strategjike të qeverisë shqiptare, e artikuluar vazhdimisht edhe nga Kryeministri, duke pasur në themel rikthimin e vendit në horizontin e tij detar dhe adriatiko-jonian.

“Kjo nuk mund të ndodhë pa mjete, pa anije, pa luftanije dhe pa anije logjistike. Për këtë arsye, qeveria shqiptare ka angazhuar jo vetëm financimin e nevojshëm, por edhe kuadrin e duhur ligjor për ringritjen e Pashalimanit si një kantier strategjik, jo vetëm në dobi të forcave tona, por edhe të forcave aleate”, - u shpreh ministri Vengu.

Ministri i Mbrojtjes nënvizoi se ringritja e **Bazës Detare të Pashalimanit** dhe investimet në kapacitetet detare janë pjesë e një vizioni afatgjatë për ndërtimin e një force detare moderne, profesionale dhe plotësisht të integruar në **Aleancën e Atlantikut të Veriut (NATO)**.

Në përfundim të ceremonisë, ministri Vengu i uroi suksese komandantit të ri, personelit të Forcës Detare dhe familjeve të tyre, duke theksuar synimin për ndërtimin e një force detare të aftë për mbrojtjen e interesave kombëtare, garantimin e sigurisë detare dhe rritjen e rolit të Shqipërisë në arkitekturën e sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare.



Ministri Vengu inspektoi kompleksin stërvitor Bizë/Pajet, investim strategjik për Forcat e Armatosura

Ministri i Mbrojtjes, **Pirro Vengu**, inspektoi kompleksin stërvitor në **Bizë/Pajet**, një investim strategjik që synon modernizimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të trajnimit të Forcave të Armatosura, si dhe zhvillimin e stërvitjeve ndërkombëtare në përputhje me standardet bashkëkohore të **NATO-s**.

Gjatë inspektimit, ministri Vengu u njoh nga afër me infrastrukturën dhe kapacitetet funksionale të kompleksit, i cili përfaqëson një pol të ri modernizimi për përgatitjen operacionale të trupave dhe rritjen e ndërveprimit me partnerët ndërkombëtarë.

Kompleksi stërvitor në Bizë/Pajet ka kapacitet akomodimi deri në **1 200 persona** dhe ofron kushte të plota fjetjeje, ushqimi, ambiente moderne dhe shërbime të tjera thelbësore, duke garantuar mbështetje të plotë logjistike dhe operacionale për zhvillimin e stërvitjeve të zgjatura dhe komplekse. Ministri Vengu theksoi se ky investim përbën një element kyç për rritjen e gatishmërisë së Forcave të Armatosura dhe për forcimin e bashkëpunimit me aleatët dhe partnerët strategjikë, duke e pozicionuar Shqipërinë si një faktor aktiv dhe të besueshëm në arkitekturën e sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare. Ky kompleks stërvitor do të jetë funksional për stërvitjen kryesore të Forcave të Armatosura që pritet të zhvillohet në muajin **shtator**, për certifikimin e **Grup Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë** sipas standardeve të NATO-s, si dhe për stërvitje dypalëshe dhe shumëkombëshe, përfshirë **“Defender Europe 2027”**.



Forca Ajrore shqiptare stërvitet me Forcën Ajrore amerikane, në fokus reagimi i shpejtë në kohë krize

Forca Ajrore shqiptare zhvilloi një stërvitje të përbashkët me **Forcën Ajrore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës** në **Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës**, duke forcuar më tej ndërveprimin dhe gatishmërinë operacionale mes dy vendeve aleate në kuadër të **NATO-s**.

Stërvitja u fokusua në rritjen e aftësive për **reagim të shpejtë në kohë krize**, përmirësimin e ndërveprueshmërisë dhe përvetësimin e procedurave bashkëkohore operacionale sipas standardeve të Aleancës. Ajo u realizua në bashkëpunim me **Skudronin e 102-të të Shpëtimit të Forcës Ajrore të SHBA-ve**, me qëllim trajnimin praktik të personelit të Forcës Ajrore shqiptare në procedurat e **furnizimit me karburant në zona të përparuara (Forward Area Refueling Point – FARP)**.

Gjatë stërvitjes, në pistën e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës u realizua me sukses operacioni FARP, ku avioni ushtarak amerikan **HC-130J “Combat King”** furnizoi në tokë me karburant, në gjendje të ndezur, helikopterin **UH-60 “Black Hawk”** të Forcës Ajrore shqiptare, duke demonstruar një nivel të lartë profesionalizmi dhe koordinimi.

Pilotët e helikopterëve UH-60 “Black Hawk” theksuan se stërvitja kontribuoi ndjeshëm në rritjen e aftësive operacionale. Toger **Fabio Bardho**, komandant ekuipazhi, u shpreh se bashkëpunimi me partnerët amerikanë ka qenë tejet i vlefshëm:

“Kjo stërvitje ka shërbyer për të rritur aftësitë tona pilotuese dhe për të qenë gati sa më shpejt për operacionet luftarake që mund të ndodhin në fushëbetejë”.

Duke dhënë detaje mbi rëndësinë e këtij trajnimi, **nënkolonel Ervin Buzi**, komandant i Bazës Ajrore të Farkës, theksoi se stërvitja përbën risi për Forcën Ajrore shqiptare dhe hap një kapitull të ri në zhvillimin e kapaciteteve ajrore:

“Është një mundësi për rritjen e aftësive të ekuipazheve tona për të kryer operacione pa ndaluar



helikopterin, duke garantuar vazhdimësi më të gjatë të misioneve dhe mbështetje efektive për trupat tona. Ky është një hap i rëndësishëm në bashkëpunim me aleatin amerikan dhe aleatët e NATO-s”.



Nga ana e tij, **nënkolonel Richard Bloom**, komandant i ekuipazhit të avionit amerikan HC-130J “Combat King”, vlerësoi profesionalizmin e Forcës Ajrore shqiptare gjatë stërvitjes:

“Kjo ishte hera e parë që Forca Ajrore shqiptare realizonte operacione FARP dhe performanca e tyre ishte absolutisht profesionale. Ishim vërtet me fat që punuam me ta”.

Stërvitja përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt **modernizimit të kapaciteteve ajrore** dhe forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar të Forcës Ajrore shqiptare, veçanërisht me aleatët strategjikë të NATO-s dhe **Bazën Ajrore të Avianos** në Itali.

Bashkëpunimi i vazhdueshëm mes Forcës Ajrore shqiptare dhe Forcës Ajrore amerikane dëshmon nivelin e lartë të partneritetit strategjik mes **Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës** në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

SHSHHPFA, gjeneralletenant Arben Kingji mori pjesë në takimin e Komitetit Ushtarak të NATO-s

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, **gjeneralletenant Arben Kingji**, mori pjesë në ditën e parë të takimit të **Komitetit Ushtarak të Shefave të Shtabeve të vendeve anëtare të NATO-s**, ku u zhvilluan diskutime të rëndësishme mbi mbrojtjen kolektive dhe sfidat aktuale të sigurisë.

Gjatë punimeve, vëmendja u përqendrua në vlerësimin e mjedisit të sigurisë, rritjen e aftësive ushtarake dhe luftarake, si dhe nevojën për **inovacion dhe përshtatje të shpejtë** për t'u përballur me sfidat e së ardhmes.

Në diskutime u theksua rëndësia e **gatishmërisë operacionale**, përmirësimit të **ndërveprueshmërisë ndërmjet forcave aleate dhe partnere**, si dhe menaxhimit proaktiv të rreziqeve, si elementë kyç për garantimin e sigurisë kolektive.

Gjeneralletenant Kingji vlerësoi kohezionin e Aleancës së Atlantikut të Veriut, duke ritheksuar se **uniteti dhe solidariteti ndërmjet vendeve anëtare të NATO-s** mbeten garanci për sigurinë e përbashkët, në një mjedis të karakterizuar nga sfida gjithnjë e më komplekse.

Takimi i Komitetit Ushtarak të NATO-s përbën një forum të rëndësishëm strategjik për koordinimin e qëndrimeve dhe forcimin e rolit të Aleancës në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit euroatlantik.



Ekipi i ERCC/BE, vizitë në Bazën e Mbështetjes dhe Emergjencave Civile

Një ekip ekspertësh të **Qendrës së Koordinimit të Përgjigjes ndaj Emergjencave (ERCC)**, në kuadër të **Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian**, zhvilloi sot një vizitë njohëse në ambientet e **Bazës së Mbështetjes dhe Emergjencave Civile**.

Gjatë vizitës, përmes një brifingu prezantues, ekipi i ERCC u njoh nga afër me **misionin e bazës**, kapacitetet operacionale në luftën kundër zjarreve, si dhe sfidat e evidentuara gjatë operacioneve në mbështetje të emergjencave civile për vitin **2025**.

Ekspertët e ERCC u informuan gjithashtu mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave të reagimit, procedurat e ndërhyrjes dhe bashkëpunimin ndërinstitucional në përballimin e situatave emergjente.

Në kuadër të vizitës, ekipi i Qendrës së Koordinimit të Përgjigjeve ndaj Emergjencave u njoh nga afër me **mjetet personale dhe kolektive** të përdorura nga personeli gjatë operacioneve për **shuarjen e zjarreve**, si dhe me pajisjet teknike në dispozicion për reagim të shpejtë dhe efektiv.

Vizita konfirmoi rëndësinë e **bashkëpunimit të**



ngushtë me strukturat e Bashkimit Evropian, në funksion të forcimit të kapaciteteve kombëtare për parandalimin dhe menaxhimin e emergjencave civile.



Batalioni i Xhenios në mbështetje të autoriteteve civile në Lezhë dhe Elbasan

Batalioni i Xhenios vijon angazhimin e tij në mbështetje të autoriteteve civile, duke kontribuar në garantimin e sigurisë së komuniteteve në bashkitë **Lezhë** dhe **Elbasan**. Specialistët **EOD (Explosive Ordnance Disposal)** të Batalionit të Xhenios kanë kryer me sukses **vlerësimin, çaktivizimin dhe transportimin e municioneve ushtarake** të identifikuar në njësitë administrative **Kolsh** dhe **Mengël**, duke eliminuar rrezikun për banorët dhe mjedisin përreth.

Operacionet janë zhvilluar në koordinim të plotë me strukturat vendore dhe autoritetet përgjegjëse, në përputhje me procedurat dhe standardet e sigurisë në fuqi. Batalioni i Xhenios vijon misionin e tij për **pastrimin e sipërfaqeve nga municionet e rrezikshme**, duke kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë publike dhe mbrojtjen e jetës së qytetarëve.



Aty ku valëvitet flamuri, është Atdheu

Flamuri kombëtar, forca morale e një ushtrie moderne

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Ka simbole që nuk plaken kurrë. Ka ngjyra që nuk zbehen, edhe kur koha kalon mbi to me gjithë peshën e saj. Ka shenja që nuk janë thjesht copë pëlhure, por janë histori, gjak, sakrificë, betim dhe nder. Flamuri ynë kombëtar është një prej tyre. Është jo vetëm flamuri më i bukur në botë, por edhe ai që, sa herë valëvitet, bëhet edhe më i bukur sepse mbi të rëndojnë kujtesa, krenari dhe përgjegjësi.

Flamuri kuqezi nuk është vetëm një simbol shtetëror. Ai është vetë shpirti i kombit shqiptar. Është një flamur që nuk u dha, por u fitua. Që nuk u trashëgua në paqe, por u ngrit në stuh. Që nuk u valëvit gjithmonë lirshëm, por edhe atëherë kur u ndalua, vazhdoi të jetojë në zemrat e shqiptarëve, në këngë, në poezi, në betime të pathëna, në uniforma dhe në qëndresë.

Flamuri si betim i përjetshëm

Për çdo ushtarak shqiptar, flamuri nuk është një objekt ceremonial. Ai është një betim i përjetshëm. Është arsyeja pse ushtari ngrihet më herët, pse stërvitet më fort, pse qëndron më gjatë në shi, në borë apo në vapë. Është arsyeja pse ai mbron jo vetëm territorin, por edhe dinjitetin kombëtar. Në kazermat e Forcave të Armatosura, flamuri nuk është dekor. Ai është busull morale. Është kujtesë e vazhdueshme se uniforma nuk vishet për privilegj, por për shërbim. Se grada nuk është pushtet, por përgjegjësi. Se arma nuk është forcë, por mbrojtje. Kur flamuri ngrihet në mëngjes, ai ngrihet bashkë me ndërgjegjen e çdo ushtaraku. Kur ulet në mbrëmje, ai ulet mbi një ditë detyre të kryer, mbi lodhje të ndershme dhe mbi besimin se Shqipëria është më e sigurt.

Flamuri dhe Ushtria, një histori e pandarë

Historia e Ushtrisë Shqiptare është e shkruar nën hijen e flamurit kuqezi. Nga formacionet e para kombëtare, te strukturat moderne të sotme, flamuri ka qenë gjithmonë pika e referimit. Ai ka udhëhequr breza ushtarakësh në kohë paqeje dhe në kohë krize, në reforma të vështira dhe në misione ndërkombëtare. Sot, flamuri shqiptar valëvitet jo vetëm në Tiranë, por edhe në misione të NATO-s, në operacione paqeruajtëse, në vende ku uniforma shqiptare përfaqëson jo vetëm shtetin, por edhe vlerat euroatlantike që kemi zgjedhur me bindje. Çdo herë që flamuri ynë ngrihet përkrah flamujve të aleatëve, ai bëhet edhe më i bukur, sepse tregon se Shqipëria është e barabartë, e besueshme dhe dinjitoze.

Bukuria që vjen nga sakrifica

Flamuri nuk do të ishte kaq i bukur pa sakrificat që mbart. Çdo fije e tij është e lagur nga gjaku i atyre që ranë për liri. Nga dëshmorët e pavarësisë, te ata që dhanë jetën për mbrojtjen e atdheut, flamuri është arkiv i heshtur i heroizmit shqiptar.

Në çdo përvjetor, në çdo ceremoni, në çdo homazh, flamuri bëhet edhe më i rëndë jo nga pesha e pëlhurës, por nga pesha e kujtesës. Dhe pikërisht kjo peshë e bën atë më të bukur. Sepse bukuria e vërtetë nuk është sipërfaqësore; ajo lind nga domethënia.

Flamuri si përgjegjësi për brezat e rinj

Sot, më shumë se kurrë, flamuri ka nevojë të kuptohet, jo vetëm të nderohet. Brezat e rinj duhet të mësojnë se flamuri nuk është thjesht simbol feste apo fotografie, por një kontratë morale me historinë dhe të ardhmen. Ushtria ka një rol kyç në këtë edukim. Përmes disiplinës, shembullit dhe përkushtimit, ajo përcjell te të rinjtë mesazhin se atdheu nuk mbrohet vetëm me fjalë, por me vepra. Se liria nuk është e dhënë njëherë e përgjithmonë, por kërkon vigjilencë, unitet dhe përgatitje.

Kur flamuri bëhet edhe më i bukur

Flamuri bëhet edhe më i bukur kur respektohet. Kur nuk përdoret për interesa të ngushta. Kur nuk banalizohet. Kur nuk ndahet, por bashkon. Ai bëhet edhe më i bukur kur qëndron mbi institucione të forta, mbi ushtri profesionale, mbi shtet ligjor dhe mbi qytetarë që besojnë te Shqipëria. Ai bëhet edhe më i bukur kur ushtari shqiptar, me kokën lart dhe me ndërgjegjen e qetë, e mban atë në krah, duke ditur se përfaqëson një komb të lashtë, por edhe një shtet modern.

Një flamur, një ushtri, një atdhe

Në fund, flamuri ynë është më shumë se simbol. Ai është premtim. Premtim se Shqipëria do të mbrohet. Se sovraniteti nuk negociohet. Se paqja ruhet me forcë morale dhe profesionale. Se Ushtria Shqiptare do të jetë gjithmonë aty ku kërkon atdheu.

Dhe për këtë arsye, sa herë që flamuri kuqezi



valëvitet mbi uniformën shqiptare, ai nuk është thjesht më i bukur ai është më i fortë, më kuptimplotë dhe më i përjetshëm.

Flamuri që flet pa fjalë

Ka simbole që nuk kanë nevojë për shpjegim. Ato flasin vetë, edhe në heshtje. Flamuri kombëtar shqiptar është një prej tyre. Kuqezi-a e tij nuk është thjesht një kombinim ngjyrash, por një kod i thellë historik, një gjuhë e përbashkët që çdo shqiptar e kupton pa përkthim. Kur ai valëvitet, nuk lëviz vetëm një copë pëlhure – lëviz kujtesa kolektive e një kombi.

Flamuri ynë është quajtur shpesh “më i bukur i në botë”. Jo për estetikë formale, por për ngarkesën shpirtërore që mbart. Ai është flamur që ka lindur nga lufta dhe ka mbijetuar përmes sakrificës. Ka qenë i ndaluar, i fshehur, i qëndisur në fshehtësi, por kurrë i harruar. Dhe sa herë që historia e ka vënë kombin shqiptar përballë sfidave, flamuri ka qenë pika e referimit, shenja e unitetit dhe e qëndresës.

Në institucionet e Forcave të Armatosura, flamuri nuk është dekor ceremonial. Ai është prani e përditshme, kujtesë dhe betim. Ai qëndron mbi kazerma, në sheshe stërvitjeje, në ceremoni ushtarake, por mbi të gjitha qëndron në ndërgjegjen e çdo ushtaraku shqiptar.

Flamuri si betim ushtarak

Për ushtarakun shqiptar, flamuri është betimi i parë dhe i fundit. Para se të mësojë taktika, teknologji apo procedura, ai mëson kuptimin e shërbimit ndaj flamurit. Ky shërbim nuk është abstrakt. Ai përkthehet në disiplinë, sakrificë, përgjegjësi dhe gatishmëri.

Në çdo ngritje flamuri në mëngjes, përsëritet në heshtje një kontratë morale mes ushtrisë dhe kombit. Është një marrëveshje e pashkruar, por e fortë: ushtria betohet të mbrojë atdheun, ndërsa kombi i beson asaj sovranitetin dhe sigurinë.

Flamuri është gjithashtu elementi që i barazon të gjithë brenda uniformës. Para tij nuk ka grada morale. Të gjithë janë shërbyes. Të gjithë janë përgjegjës. Dhe pikërisht kjo e bën flamurin edhe më të bukur: ai nuk ndan, por bashkon. Në momente të vështira, kur vendimmarrja është e rëndë dhe presioni i madh, flamuri është kujtesë se çdo veprim bëhet jo për individin, por për Republikën e Shqipërisë.

Një histori ushtrie nën hijen kuqezi

Historia e Ushtrisë Shqiptare është e pandashme nga historia e flamurit kombëtar. Që nga formacionet e para të mbrojtjes së shtetit të ri shqiptar, e deri te Forcat e Armatosura moderne të integruara në NATO, flamuri ka qenë gjithmonë shenja orientuese. Ai është valëvitur në periudha të vështira shtetformimi, në reforma të thella strukturore dhe në momente kthesash strategjike. Ka qenë dëshmitar i gabimeve dhe i sukseseve, i rënieve dhe i ringritjeve. Por kurrë nuk ka humbur kuptimin e tij. Sot, flamuri shqiptar valëvitet në misione ndërkombëtare paqeruajtëse, përkrah aleatëve strategjikë. Në ato misione, ai përfaqëson jo vetëm Shqipërinë, por edhe besueshmërinë e saj si shtet kontribuues në sigurinë globale. Kur një ushtarak shqiptar mban flamurin në një mision jashtë vendit, ai mban mbi supë historinë e një kombi të vogël në numër, por të madh në dinjitet.

Histori dhe sakrificë

Flamuri nuk do të kishte këtë peshë, nëse nuk do të ishte paguar me sakrificë. Çdo epokë e historisë shqiptare ka lënë gjurmë mbi të. Nga dëshmorët e pavarësisë, te ata që ranë në mbrojtje të integritetit territorial, flamuri është arkivi më i heshtur dhe më i sinqertë i sakrificës kombëtare. Në ceremonitë përkujtimore, flamuri nuk është thjesht pjesë e protokollit. Ai është prani morale. Ai ulet mbi arkivole, ngrihet në nderime dhe mbetet pas si simbol i vazhdimësisë. Sakrifica individuale bëhet pjesë e një historie më të madhe, kombëtare. Kjo është arsyeja pse flamuri bëhet gjithnjë e më i bukur me kalimin e kohës. Jo sepse ndryshon forma, por sepse shtohet domethënia.

Flamuri dhe brezat e rinj

Sfida e sotme nuk është vetëm ta nderojmë flamurin, por ta kuptojmë. Brezat e rinj jetojnë në një realitet të globalizuar, ku simbolet shpesh relativizohen. Pikërisht këtu roli i ushtrisë dhe i institucioneve shtetërore bëhet thelbësor.

Edukimi patriotik nuk është retorikë, por proces. Ai ndërtohet përmes shembullit, korrektësisë dhe profesionalizmit. Kur të rinjtë shohin një ushtri të disiplinuar, të trajnuar dhe të ndershme, ata kuptojnë se flamuri nuk është relike, por udhërrëfyes.

Flamuri duhet t'u flasë brezave jo si nostalgji, por si përgjegjësi për të ardhmen.

Një flamur, një ushtri, një atdhe

Kur flamuri më i bukur në botë bëhet edhe më i bukur? Kur respektohet. Kur mbrohet nga banalizimi. Kur qëndron mbi institucione të forta dhe mbi një ushtri profesionale, të përkushtuar dhe besnike ndaj Kushtetutës Ushtria Shqiptare mbetet një nga shtyllat më të rëndësishme të shtetit. Dhe mbi këtë shtyllë, flamuri nuk është thjesht simbol, është mision.

Sa herë që kuqezi-a valëvitet mbi uniformën shqiptare, ajo na kujton se atdheu nuk është abstrakt. Ai ka emër, histori dhe përgjegjësi. Dhe për këtë arsye, flamuri ynë nuk është vetëm i bukur. Ai është i përjetshëm.



105 VITE ARMA E XHENIOS

Një shekull shërbim, sakrificë dhe rindërtim për Shqipërinë

Ceremoni solemne për 105-vjetorin e Armës së Xhenios – Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu: Xhenio, simbol i profesionalizmit dhe një shtyllë e ushtrisë moderne

105-vjetori i themelimit të Armës së Xhenios u shënuar me ceremoni solemne, në prani të ministrit të Mbrojtjes Pirro Vengu, drejtuesve të lartë ushtarakë, ish-komandantëve të forcës xheniere, veteranëve dhe ushtarakëve në rezervë e në lirim. Një datë e veçantë për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që përkujton një shekull histori, sakrificë dhe shërbim të pandërprerë ndaj atdheut dhe komunitetit.

Ministri i Mbrojtjes: Xhenio, forcë që ndërton siguri dhe komunitete

Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu vlerësoi kontributin historik dhe aktual të Batalionit të Xhenios në mbështetje të sigurisë kombëtare, zhvillimin e infrastrukturës dhe përballimin e emergjencave civile.

Ai theksoi se përvjetori nuk është vetëm një moment festiv, por një reflektim mbi domosdoshmërinë e rritjes së vazhdueshme të kapaciteteve profesionale dhe teknike të kësaj force.

“Thelbi i këtij përvjetori lidhet me nevojën për një forcë gjithnjë e më të specializuar, e aftë jo vetëm për veprime luftarake, por edhe për administrimin e rrezikut në kohë paqeje dhe në detyra civile”.

Ministri nënvizoi se reparti xhenier është ndër komponentët më të angazhuar të Forcave të Armatosura, i pranishëm si në misionet ndërkombëtare, ashtu edhe në situata emergjente brenda vendit.



RRËNJËT HISTORIKE TË ARMËS SË XHENIOS

Nga Skënderbeu te shteti shqiptar modern

Historia e Armës së Xhenios nis zyrtarisht më 20 janar 1921, me vendim të qeverisë së dalë nga Kongresi i Lushnjës, kur u krijua Kompania e Parë Xheniere në Divizionin e Ushtrisë Kombëtare.

Por tradita xheniere shqiptare shkon shumë më herët. Gjergj Kastrioti Skënderbeu përdori elementë që

sot konsiderohen veprime klasike xheniere: maskim, mashtrim, bllokim rrugësh, pengesa artificiale, zjarre për prodhim tymi dhe mjete goditëse si Gurëdhësi shqiptar.

Në vitet 1928–1929 u krijua komanda e parë e trupave xheniere, ndërsa deri në pushtimin fashist ushtria shqiptare kishte 10 kompani xheniere në shërbim të ushtrisë dhe komunitetit.



LUFTA, ÇLIRIMI DHE ÇMINIMI I VENDIT
Xhenio në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare

Gjatë LANÇ-it, elementët e veprimit xhenier u shndërruan në faktor vendimtar për veprimet partizane: lufta me mina, pengesa, shkatërime infrastrukturore dhe ndërtimi i barrikadave.

Më 10 prill 1944, me urdhrin nr.116 të SHPUNAÇL, u krijuan skuadrat e para minatore-zapatore. Pas çlirimit, më 26 maj 1945, u formua reparti i parë xhenier (Batalioni Zapator-Minator), i cili u angazhua në çminimin e bregdetit shqiptar.

Rreth 400 kilometra vijë bregdetare ishin të minuara nga ushtria nazifashiste me mbi 300 mijë mina. Në këtë mision ranë heroikisht dhjetëra xhenierë shqiptarë.

“Xhenio ishte arma që i ktheu tokën popullit dhe jetën komunitetit”

XHENIO NË LUFTËN E FTOHTË DHE MBROJTJEN KOMBËTARE
Ndërtimi i fortifikimeve dhe infrastrukturës strategjike

Nga vitet 1960 deri në vitet 1985, trupat xheniere luajtën rol kyç në ndërtimin e sistemit mbrojtës të vendit, objekte fortifikuese, pika zjarri, tunele, baza dhe strehime për popullatën.

Sot, këto vepra vlerësohen nga studiues të huaj si ndër më cilësoret në rajon. Objekte si Gjadri, Porto Palermo, Kuçova, Shëngjini dhe komplekse të tjera mbeten dëshmi e profesionalizmit të xhenierëve shqiptarë.



PAS VITIT 1990: XHENIO NË SHËRBIM TË KOMUNITETIT
Nga mbrojtja te rindërtimi

Pas vitit 1990, pavarësisht reformave dhe shkurtimeve



strukture, trupat xheniere u shndërruan në një forcë të domosdoshme për emergjencat civile dhe zhvillimin lokal.

Ndërtimi i rrugëve, urave “Bailey”, ujësjellësve, pastrimi i zonave të minuara, përballimi i përmytjeve, tërmete dhe zjarre – janë vetëm një pjesë e misioneve të kryera në të gjithë territorin e vendit.

Nuk ka zonë nga Saranda në Shkodër, nga Tropoja në Gjirokastrë, ku Xhenio të mos ketë lënë gjurmë.

URAT “BAILEY” & EMERGJENCAT CIVILE
Lidhje që bashkojnë komunitetet

Urat “Bailey” janë shndërruar në simbol të misionit human të Armës së Xhenios. Vetëm gjatë vitit 2024 u ndërtuan 8 ura me gjatësi totale 207 metra, ndërsa për vitin 2025 janë planifikuar 12 ura të reja në zonat më të nevojshme të vendit.

“Urat nuk janë thjesht vepra infrastrukturore, por lidhje që rikthejnë jetën dhe shpresën për komunitetet”, – u shpreh ministri Vengu.

Xhenio ka qenë gjithnjë në vijën e parë në Gërdec (2008), pas shpërthimeve të vitit 1997, në pastrimin e zonave të minuara në Kukës e Tropojë pas vitit 1999, si dhe në dhjetëra emergjenca të tjera kombëtare.

NDERIM, TRASHËGIMI DHE E ARDHMJJA
105 vite krenari kombëtare

Mbi 160 dëshmorë, qindra të plagosur, 5 Heronj të Popullit, Heronj të Punës, gjeneralë, kolonelë, inxhinierë dhe kuadro të shquar – kjo është trashëgimia e Armës së Xhenios.

Figura si ish-xhenieri dhe Presidenti i Republikës, Dr. Alfred Moisiu, përfaqësojnë kulmin e këtij kontributi historik.

105 vite Arma e Xhenios janë 105 vite shërbim ndaj Atdheut, mbi politikën dhe interesat e momentit.

Lavdi dëshmorëve të Armës së Xhenios!
Nderim brezave të xhenierëve shqiptarë!



REZOLUTA 1325 DHE FORCAT E ARMATOSURA TË SHQIPËRISË

Gratë, Paqja dhe Siguria si komponent i sigurisë kombëtare dhe angazhimeve euroatlantike



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Angazhimi institucional i Shqipërisë në zbatimin e Rezolutës 1325

Republika e Shqipërisë, si anëtare e Kombeve të Bashkuara dhe e Aleancës së Atlantikut të Veriut (NATO), ka përqafuar dhe zbatuar parimet e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, duke i integruar ato në politikat kombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes.

Për Forcat e Armatosura të Shqipërisë, Rezoluta 1325 përbën një **udhëzim strategjik** që orienton:

- zhvillimin e burimeve njerëzore,
- planifikimin operacional,
- pjesëmarrjen në misionet ndërkombëtare për paqe dhe siguri.

Ky angazhim reflekton vizionin e Ministrisë së Mbrojtjes për një ushtri moderne, profesionale dhe gjithëpërfshirëse.

Gratë në Forcat e Armatosura të Shqipërisë, pjesë aktive e strukturave operacionale

Në përputhje me standardet e NATO-s dhe OKB-së, FASH kanë rritur vazhdimisht përfshirjen e grave në radhët e tyre, duke i integruar ato në:

- struktura komanduese dhe shtabe,
- njësi logjistike dhe mbështetëse,
- misione jashtë vendit.

Gratë ushtarake shqiptare kontribuojnë në mënyrë aktive në përmbushjen e detyrave operacionale, duke dëshmuar se profesionalizmi ushtarak ndërtohet mbi aftësi, trajnim dhe disiplinë, pa dallim gjinor.

Rezoluta 1325 në praktikë: përvoja e FASH në misionet ndërkombëtare

Forcat e Armatosura të Shqipërisë kanë marrë pjesë ndër vite në një sërë operacionesh dhe misionesh paqeruajtëse, ku parimet e Rezolutës 1325 janë zbatuar konkretisht.

Në Afganistan, ku Shqipëria kontribuoi për një periudhë të gjatë në kuadër të misioneve të NATO-s, personeli ushtarak shqiptar, përfshirë edhe gra, u angazhua në:

- bashkëpunimin me komunitetet lokale,
- mbështetjen e popullsisë civile,
- krijimin e një ambienti më të sigurt për gratë dhe fëmijët.

Prania e grave ushtarake shqiptare në këto misione ka lehtësuar komunikimin me gratë vendase, duke rritur efektivitetin e ndërveprimit civil-ushtarak.

Kontributi në KFOR dhe siguria rajonale

Në misionin e NATO-s në Kosovë (KFOR), Forcat e Armatosura të Shqipërisë kanë dhënë një kontribut të vazhdueshëm për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit rajonal.

Zbatimi i Rezolutës 1325 në këtë mision është reflektuar në:

- respektimin e plotë të mbrojtjes së civilëve,
- ndjeshmërinë ndaj nevojave të grave dhe vajzave,
- angazhimin profesional të personelit në përputhje me ligjin ndërkombëtar humanitar.

Kjo përvojë ka forcuar kapacitetet e FASH dhe ka rritur besueshmërinë e Shqipërisë si kontribuues serioz në sigurinë euroatlantike.

Trajnimi dhe përgatitja sipas standardeve të NATO-s dhe OKB-së

Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Shqipërisë kanë integruar parimet e Rezolutës 1325 në programet e trajnimit ushtarak, duke përfshirë:

- edukimin mbi të drejtat e njeriut,
- ligjin ndërkombëtar humanitar,



- mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore në situata konflikti.

Këto trajnime synojnë përgatitjen e personelit për operacione komplekse, ku siguria ushtarake ndërthuret me mbrojtjen e dinjitetit njerëzor.

Rezoluta 1325 si pjesë e politikës së mbrojtjes shqiptare

Zbatimi i Rezolutës 1325 nga FASH përforcon lidhjen ndërmjet:

- mbrojtjes kombëtare,
- angazhimeve ndërkombëtare,
- promovimit të paqes dhe stabilitetit.

Ky proces kontribuon në ndërtimin e një kulture institucionale që vlerëson barazinë, përgjegjësinë dhe profesionalizmin si elemente thelbësore të sigurisë moderne.

Një ushtri moderne në shërbim të paqes

Rezoluta 1325 është sot pjesë përbërëse e identitetit të Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Ajo udhëzon veprimtarinë ushtarake drejt:

- rritjes së efektivitetit operacional,
- forcimit të besimit të publikut,
- dhe konsolidimit të rolit të Shqipërisë si faktor paqeje në rajon dhe më gjerë.

Forcat e Armatosura të Shqipërisë mbeten të angazhuara për të kontribuar në paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, në përputhje me parimet e OKB-së, NATO-s dhe vlerat demokratike që udhëheqin shtetin shqiptar.

Statistika të integruara: Pjesëmarrja e grave në Forcat e Armatosura të Shqipërisë

Në kuadër të përpjekjeve për implementimin e Agjendës së OKB-së “**Gratë, Paqja dhe Siguria**”, Forcat e Armatosura të Shqipërisë kanë arritur përmirësime të dukshme në përfaqësimin gjinor, me statistika konkrete që tregojnë progresin në përfshirjen e grave në strukturat e sigurisë kombëtare.

Përqindja e grave në Forcat e Armatosura

Sipas të dhënave të fundit të përmbledhura për vitin 2024:

- **15.7%** e totalit të personelit ushtarak të FASH përbëhen nga gra ushtruese, duke përmbushur apo tejkaluar standardet e NATO-s për përfshirjen e grave në Forcat e Armatosura.

- Kur gjithë stafi (ushtarakë dhe civilë) merret së bashku, **rreth 20.8%** e Forcave të Armatosura të Shqipërisë janë gra.

Këto shifra reflektojnë një trend rritës në pesë vitet

e fundit, nga rreth **14.3% në vitin 2022** deri në 15.7% në 2024.

Përfaqësimi sipas gradave dhe roleve

Të dhënat tregojnë ndryshime të rëndësishme në strukturën gjinore të FASH:

- Rreth **22%** e oficerëve ushtarakë janë gra një indikator i rëndësishëm i avancimit të të drejtave udhëheqëse dhe profesionalizmit gjinor.

- Në nivelet e nënoficerëve (NCO), gratë përbëjnë **rreth 13%**, ndërkohë që rreth **12.4%** e rekrutëve të rinj ushtarake janë gra, duke treguar një tendencë rritjeje edhe në radhët fillestare.

Përfshirja në misionet ndërkombëtare

Pjesëmarrja e grave shqiptare në misionet paqeruajtëse dhe operacionet ndërkombëtare reflekton punën e FASH për të integruar agjendën “Gratë, Paqja dhe Siguria” në praktikë:

- Gjatë vitit 2024, **rreth 8.57%** e personelit të pozicionuar në misionet jashtë vendit ishin gra, të përfshira në operacione të ndryshme të NATO-s, OKB-së dhe BE-së në rajone të tilla si **KFOR (Kosovë)**, **Mali i Jugut**, **Letonia (eFP)**, Bosnjë e Hercegovinë dhe Detin Egje.

Edhe pse kjo përqindje është më e ulët se ajo e përgjithshme në forcë, ajo tregon një hap praktik drejt përfshirjes më të madhe të grave në pozicione operacionale ndërkombëtare.

Rritja e prezencës gjinore në kohë

Deri në vitin 2020, përfaqësimi i grave në Forcat e Armatosura të Shqipërisë ishte rreth **14.01%**, me rritje të gradual dhe të qëndrueshme nga viti 2019. Kjo paraqet një trend pozitiv të avancimit të barazisë gjinore, përmes politikave të trajnimit, rekrutimit dhe zhvillimit profesional brenda FASH.

Gratë në pozita komandimi dhe udhëheqjeje


Një tjetër tregues i rëndësishëm i integritetit është prezenca e grave në pozita vendimmarrëse:

Të dhënat tregojnë se Forcat e Armatosura të Shqipërisë po ecin përpara në zbatimin e parimeve të Rezolutës 1325, duke përmirësuar përfaqësimin dhe rolin e grave në ushtri, jo vetëm si mbështetje, por si anëtare aktive dhe profesioniste të strukturave ushtarake dhe operacionale.

Ky progres statistikor jo vetëm përmbush standardet ndërkombëtare, por edhe forcon **kapacitetin kombëtar të sigurisë dhe angazhimin e Shqipërisë në paqeruajtje dhe stabilitet global**, në përputhje me detyrimet e vendit ndaj OKB-së dhe NATO-s.

MAJOR ELSON FETI

Atdheu mbi gjithçka, guximi mbi çdo sfidë



MAJOR (R) NEXHBEDIN BASHA

Një oficer i formuar në traditë, disiplinë dhe sakrificë

Major Elson Petrit Feti, i lindur më 5 prill 1985, në Bulqizë, përfaqëson sot modelin e oficerit modern të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. I rritur në një familje me traditë të thellë ushtarake, ai e trashëgoi uniformën jo thjesht si profesion, por si mision jetësor dhe amanet brezash.

Babai i tij, nënkolonel Petriri, oficer karriere në Forcat e Armatosura, ishte modeli i parë i disiplinës, përkushtimit dhe besnikërisë ndaj Atdheut. Këshilla që i dha të birit në ditën e parë të veshjes së uniformës, u shndërrua në busull morale për gjithë rrugëtimin e tij ushtarak:

“Bir, detyra e ushtarakut nuk është e lehtë. Do të përballësh me rreziqe për jetën, si në paqe ashtu edhe në luftë. Do të duhet të ngrihesh natën dhe të shkosh aty ku të kërkon Atdheu. Detyra jote është të jesh gjithmonë gati.”

Ky amanet ka qenë gjithmonë i pranishëm në çdo mision, çdo vendimarrje dhe çdo përgjegjësi që Major Feti ka mbajtur mbi supe.

Formimi akademik dhe rrugëtimi profesional

Major Elson Feti i përket brezit të parë të Universitetit Ushtarak “Skënderbej”, ku u diplomua në specialitetin Këmbësori, paralelisht me studimet civile në Menaxhim Biznesi (2004–2008).

Karriera e tij është ndërtuar kryesisht në repartet elitare të **Batalionit “Komando”**, duke kaluar me profesionalizëm dhe përkushtim çdo shkallë komanduese:

- Komandant Toge
- Zëvendëskomandant Kompanie
- Komandant Kompanie
- Shef i Zbulimit (2024–2025)

Aktualisht, ai ndjek **Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP)**, një etapë kyçe drejt gradës së **Nënkolonelit** dhe përgjegjësive më të larta drejtuese.

Ekspertizë sipas standardeve të NATO-s

Përgatitja profesionale e Major Fetit është forcuar përmes një sërë stërvitjesh kombëtare dhe ndërkombëtare në: Jubë, Rreth-Greth, Bizë, Feiken, Pukë, Pashaliman, si dhe në **Gjermani, Angli dhe Turqi**. Këto përvoja e kanë formuar si ekspert të operacioneve speciale, të përputhura plotësisht me standardet dhe doktrinën e NATO-s, duke e bërë një oficer të besueshëm në çdo mision shumëkombësh.

Në shërbim të paqes ndërkombëtare

Major Elson Feti ka përfaqësuar me dinjitet Shqipërinë në misione paqeruajtëse të rëndësishme:



- **Afganistan** – tre herë (ISAF / RSM)
- **Kosovë – KFOR** (2022)

Në vitin 2022, ai u caktua **Komandant i Kontingjentit të parë shqiptar “KFOR-1”**, duke shënuar një moment historik për praninë shqiptare në misionet paqeruajtëse në rajon.

Ky mision nuk ishte vetëm detyrë ushtarake, por një simbol i përgjegjësisë rajonale dhe angazhimit strategjik të Shqipërisë për paqen dhe stabilitetin në Ballkan.



Misioni “KFOR-1” – Një epokë e re për Forcat e Armatosura Shqiptare

Në zemër të tensioneve ballkanike

Më 28 shkurt 2022, 30 komando shqiptarë u nisën drejt Pejës, Kosovë, për misionin “KFOR-1”. Flamuri kombëtar u dorëzua me nder nga Ministri i Mbrojtjes i asaj kohe, z. Niko Peleshi, si amanet që duhej mbrojtur me përkushtim maksimal.

Në krye të kontingjentit qëndronte Major Elson Petrit Feti, një oficer i ri në moshë, por i kalitur në misione dhe përgjegjësi.

Motoja e tij ishte më shumë se fjalë: **“Atdheu mbi gjithçka, guximi mbi çdo sfidë”**.

Përgatitja profesionale e Major Fetit është forcuar përmes një sërë stërvitjesh kombëtare dhe ndërkombëtare në: Jubë, Rreth-Greth, Bizë, Feiken, Pukë, Pashaliman, si dhe në Gjermani, Angli dhe Turqi.

“Kujdestarët e Paqes”

Kosova e vitit 2022 mbetej një hapësirë me paqe të brishtë dhe tensione të herëpashershme. Në këtë realitet, komandot shqiptarë u bënë jo vetëm forcë sigurie, por edhe faktor besimi mes komuniteteve.

Të vendosur në **Camp Villaggio Italia (CVI)**, nën komandën italiane dhe në bashkëpunim me forcat kroate, ata garantuan stabilitet, profesionalizëm dhe gatishmëri të lartë operacionale.

Detyra që peshojnë rëndë

Kontingjenti “KFOR-1” realizoi me sukses detyra të ndjeshme, si:

- Ruajtja e Manastirit të Deçanit
- Patrullime të vazhdueshme në zonën RC-West
- Shërbim sigurie në bazën CVI
- Patrullime të përbashkëta me Policinë e Kosovës
- Gatishmëri si **Quick Reaction Force (QRF)**

Në realitetin ballkanik, çdo patrullë ishte më shumë se rutinë, ishte përgjegjësi historike.

Mikpritja dhe vlerësimi

Komandot shqiptarë u pritën me ngrohtësi nga popullsia lokale, si bij që kthehen në shtëpi. Aleatët ndërkombëtarë i vlerësuan për:

- Disiplinë të shkëlqyer
- Profesionalizëm të lartë
- Bashkëpunim efektiv
- Identitet kombëtar dinjitoz

Ata u shndërruan në simbol të një ushtrie që po rritet dhe po konsolidohet.

Fjala e Komandantit

“Suksesi i misionit ishte sukcesi i djemve që kisha në krah.”

Si Komandant i Kontingjentit “KFOR-1”, Major Elson Feti shpreh mirënjohjen më të thellë për efektivin “Komando”, i cili përbushoi me sukses të plotë çdo detyrë, duke dëshmuar disiplinë, profesionalizëm, gatishmëri të lartë dhe përfaqësim dinjitoz të Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

Medalje dhe vlerësime

Kontributi i tij është nderuar me medalje të rëndësishme:

- NATO – ISAF (2011, 2013)
- NATO – RSM (2016)
- Medalje Karriere (2019)
- Medalje “Luftëtar” (2020, 2023)
- Medalje “Ushtari” (2021)
- NATO – Balkans (2022)

Një oficer për kohën që vjen

Sot, Major Elson Petrit Feti përfaqëson figurën e oficerit shqiptar të shekullit XXI: i formuar, i përkushtuar, i matur dhe i gatshëm të përgjigjet me nder ndaj çdo thirrjeje të Atdheut.

Mesazhi është i qartë:

“Shqipëria është dhe do të mbetet garant i paqes, në trojet ku flitet shqip dhe më gjerë.”



SHQIPËRIA NË ZEMËR TË PARISIT:

Një mbrëmje kulturore që bashkoi diplomacinë, artin dhe miqësinë franko-shqiptare

Paris – Një mbrëmje kushtuar Shqipërisë nën dritat e Aleancës Franceze

Në një nga hapësirat më prestigjioze kulturore të kryeqytetit francez, Teatri i Aleancës Franceze në zemër të Parisit, u zhvillua një mbrëmje e veçantë kushtuar Shqipërisë, e organizuar nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Francë, në bashkëpunim me televizionin ndërkombëtar TV5 Monde. Ky aktivitet i rëndësishëm kulturor dhe diplomatik shënoi një moment të veçantë për promovimin e imazhit të Shqipërisë në Francë dhe më gjerë, duke e vendosur kulturën shqiptare në qendër të vëmendjes së publikut dhe mediave franceze.

Mbrëmja, e cila do të transmetohet si pjesë e programeve të televizioneve franceze, u shndërrua në një platformë të rëndësishme komunikimi ndërkulturor, ku arti, muzika dhe diplomacia u ndërthurën në mënyrë harmonike për të përcjellë vlerat, traditat dhe identitetin kulturor shqiptar.

Një bashkëpunim prestigjioz: Diplomaci kulturore në nivel ndërkombëtar

Organizimi i kësaj mbrëmjeje ishte fryt i një bashkëpunimi të ngushtë midis Ambasadës Shqiptare në Paris dhe TV5 Monde, një prej rrjeteve televizive frankofone më të njohura në botë. Ky bashkëpunim dëshmon rëndësinë që Shqipëria i kushton diplomacisë kulturore si një mjet thelbësor për forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe për ndërtimin e një imazhi bashkëkohor dhe dinamik në arenën evropiane.

Përzgjedhja e Aleancës Franceze si vendi ku u zhvillua aktiviteti nuk ishte e rastësishme. Ky institucion, simbol i kulturës dhe gjuhës franceze, përfaqëson një urë të fortë lidhëse mes Francës dhe vendeve partnere, duke e bërë mbrëmjen një akt domethënës të dialogut kulturor franko-shqiptar.

Pjesëmarrje e nivelit të lartë institucional dhe kulturor

Mbrëmja u ndërrua me pjesëmarrjen e personaliteteve të rëndësishme nga bota institucionale, politike, kulturore dhe mediatike. Të pranishëm ishin:

- Presidenti i Fondacionit të Aleancës Franceze,
- Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Francë,
- Presidentja e TV5 Monde,
- Përfaqësues të trupit diplomatik,
- Figura të njohura të jetës politike dhe kulturore franceze,
- Përfaqësues të medias,
- Miq dhe dashamirës të Shqipërisë.

Prania e këtyre personaliteteve i dha aktivitetit një peshë të veçantë, duke e shndërruar mbrëmjen jo vetëm në një ngjarje artistike, por edhe në një forum simbolik të miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve.

Fjalët përshëndetëse: Shqipëria mes traditës dhe vizionit evropian

Në fjalën e tij përshëndetëse, Ambasadori i Shqipërisë në Francë theksoi rëndësinë e kulturës si një element kyç në ndërtimin e marrëdhënieve të qëndrueshme mes popujve. Ai vuri në dukje se Shqipëria, përmes artit dhe muzikës, dëshiron të prezantohet si një vend me identitet të pasur kulturor, por edhe me një vizion të qartë evropian.

Nga ana e saj, Presidentja e TV5 Monde nënvizoi rolin e medias frankofone në promovimin e diversitetit kulturor dhe shprehu kënaqësinë që TV5 Monde ishte pjesë e kësaj mbrëmjeje kushtuar Shqipërisë, një vend me histori, tradita dhe energji krijuese që meriton të



njihet më shumë nga publiku ndërkombëtar.

Koncerti: Tinguj shqiptarë në skenën parizene

Pas pjesës zyrtare, mbrëmja vijoi me një koncert artistik të nivelit të lartë, ku skena e Aleancës Franceze u mbush me tingujt e muzikës shqiptare. Artistë të njohur shqiptarë sollën para publikut një repertor të pasur, që përfshinte elemente të muzikës tradicionale, klasike dhe bashkëkohore, duke krijuar një udhëtim muzikor përmes historisë dhe shpirtit shqiptar.

Publiku parizien, i njohur për ndjeshmërinë dhe kulturën e tij artistike, e priti koncertin me interes dhe entuziazëm, duke e shpërblyer performancën me duartrokitje të gjata dhe emocione të dukshme.

OSFA – Një vlerë e shtuar artistike dhe institucionale

Një nga pikat kulmore të mbrëmjes ishte pjesëmarrja e OSFA-së – Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, e cila solli një performancë të nivelit të lartë artistik. Interpretimi i orkestrës u vlerësua si një vlerë e shtuar e aktivitetit, jo vetëm për cilësinë muzikore, por edhe për mesazhin simbolik që përcolli: profesionalizëm, disiplinë dhe përkushtim ndaj kulturës kombëtare.

OSFA interpretoi vepra që pasqyronin bukurinë e muzikës shqiptare, duke ndërthurur elemente tradicionale me format simfonike, çka i dha koncertit një dimension solemn dhe përfaqësues.

Një pasqyrim mediatik me ndikim të gjerë

Fakti që kjo mbrëmje do të transmetohet në

televizionet franceze përmes rrjetit TV5 Monde i jep aktivitetit një ndikim të gjerë ndërkombëtar. Miliona shikues frankofonë në Evropë, Afrikë, Amerikë dhe Kanada do të kenë mundësinë të njihen me Shqipërinë përmes një këndvështrimi kulturor dhe artistik, larg stereotipave dhe paragjytimeve.

Ky pasqyrim mediatik përbën një hap të rëndësishëm në promovimin e imazhit të Shqipërisë si një vend me potencial kulturor, artistik dhe turistik.

Kultura si urë miqësie mes popujve

Mbrëmja kushtuar Shqipërisë në Paris ishte më shumë se një aktivitet protokollar apo një koncert. Ajo ishte një dëshmi konkrete e fuqisë së kulturës për të ndërtuar ura komunikimi, për të afruar popujt dhe për të forcuar marrëdhëniet dypalëshe.

Në një kohë kur dialogu ndërkulturor është më i rëndësishëm se kurrë, kjo ngjarje shërbeu si një shembull i suksesshëm i diplomacisë kulturore, ku arti u bë gjuha e përbashkët që bashkoi Shqipërinë dhe Francën në zemër të Parisit.

Një mbrëmje që lë gjurmë

Në përfundim, mbrëmja e organizuar nga Ambasada e Shqipërisë në Paris dhe TV5 Monde do të mbetet një moment i veçantë në kalendarin kulturor shqiptar jashtë vendit. Ajo dëshmoi se Shqipëria ka shumë për të treguar dhe për të ndarë me botën, përmes muzikës, artit dhe njerëzve të saj.

Një mbrëmje elegante, dinjitoze dhe plot emocione, që e solli Shqipërinë më afër Parisit dhe Parisin më afër Shqipërisë.



KONGRESI I LUSHNJËS (1920)

Akti i shpëtimit të shtetit shqiptar

Kongresi i Lushnjës, imbajtur nga 21 deri më 31 janar 1920, përfaqëson një nga momentet më vendimtare në historinë e shtetit shqiptar. Ai nuk ishte thjesht një mbledhje politike, por një akt i guximit kombëtar dhe i vetëdijes historike, në një kohë kur ekzistenca e Shqipërisë si shtet ishte realisht e rrezikuar.

Konteksti historik dhe rreziku i copëtimit

Pas shpalljes së pavarësisë në vitin 1912 dhe njohjes ndërkombëtare në 1913, Shqipëria mbeti një shtet i brishtë, me territore të mëdha jashtë kufijve dhe pa institucione të qëndrueshme. Lufta e Parë Botërore e thelloi edhe më shumë krizën, vendi u shndërrua në fushë kalimi për ushtritë e huaja, ndërsa fuqitë e mëdha planifikonin hapur copëtimin e tij përmes Traktatit të fshehtë të Londrës (1915) dhe marrëveshjeve të tjera dypalëshe.

Në këtë klimë kaosi të brendshëm dhe presioni të jashtëm, Qeveria e Durrësit u perceptua gjerësisht si e paaftë dhe e varur nga interesat italiane, duke humbur legjitimitetin kombëtar. Shqipëria ndodhej përballë një dileme ekzistenciale: ose do të organizohej si shtet sovran mbi forcat e veta, ose do të zhdukej nga harta politike e Ballkanit.

Kongresi si shprehje e sovranitetit kombëtar

Kongresi i Lushnjës u mbledh si përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj këtij rreziku. Përfaqësues nga pothuajse të gjitha krahinat e vendit u mbledhën në shtëpinë e patriotit Kaso Fuga, duke e shpallur veten një kuvend kombëtar të plotfuqishëm. Ky akt në vetvete përbënte një sfidë të hapur ndaj ndërhyrjeve të huaja dhe strukturave politike të varura prej tyre.

Vendimet e Kongresit kishin karakter shtetformues:

- rrëzimi i Qeverisë së Durrësit,
- krijimi i Këshillit të Lartë si organ kolegjal i kryetarit të shtetit,
- zgjedhja e një qeverie të re me kryeministër Sulejman Delvinën,
- shpallja e Tiranës si kryeqytet,
- dhe përfaqësimi i Shqipërisë në arenën ndërkombëtare me delegatë legjitimë.

Këto vendime e nxorën Shqipërinë nga paraliza politike dhe i dhanë vendit një qendër reale pushteti.

Roli i vendosur i strukturave shtetërore dhe faktorit ushtarak

Një element kyç i suksesit të Kongresit ishte vendosmëria për zbatimin praktik të vendimeve të tij. Qëndrimi i Ministrit të Brendshëm Ahmet Zogu, i cili refuzoi çdo kompromis me autoritetet italiane dhe qeverinë e Durrësit, dëshmoi se shteti shqiptar i dalë nga Kongresi nuk do të mbetej në letër.

Përballja në Kavajë me forcat italiane dhe tërheqja e tyre pa konflikt të armatosur shënoi një moment simbolik të afirmimit të autoritetit shtetëror shqiptar. Qeveria e Tiranës filloi menjëherë organizimin e administratës, xhandarmërisë dhe strukturave të sigurisë, duke i dhënë fund gradualisht anarkisë.

Nga Kongresi i Lushnjës te pavarësia reale

Vendimet e Kongresit krijuan kushtet politike dhe morale që çuan drejtpërdrejt në Luftën e Vlorës dhe largimin e trupave italiane në vitin 1920. Kjo tërheqje e bëri të pamundur zbatimin praktik të planeve të copëtimit dhe hapi rrugën për njohjen ndërkombëtare të Shqipërisë.

Formimi i qeverisë/kabinetit u realizua më 30 janar 1920. Sotir Peci propozoi që qeveria të kishte 6 anëtarë dhe votimi të ishte i fshehtë. Idhomene Kosturi, delegat i Kolonjës, propozoi që votimi të bëhej sheshazi/i hapur dhe ashtu u bë. Propozimin e emrave të ministrave e bëri delegati i Mallakastrës Bektash Cakrani. Kuptohet, që propozimi bëhej në emër të marrëveshjes që kishin bërë “operatorët politikë”, të organizimit të kongresit. Ai propozoi që në qeveri të hynin, Sulejman Bej Delvina, Ilias Bej Vrioni, Ahmet Bej Zogolli, Sotir Peci, Ndoc Çoba dhe Mehmet Konica. Ilias Vrioni nuk pranoi të ishte në kabinet për “shkaqe të veçanta” dhe u propozua Hoxhë Kadria. Por nuk ishin prezentë, Sulejman Delvina e Mehmet Konica, pasi ishin në Konferencën e Paqes në Paris, por edhe Hoxhë Kadria e Ndoc Çoba, të cilët ishin në Shkodër, nuk mundën të vinin se i penguan, kishin



përschëndetur zhvillimin e kongresit, dhe e firmosën proces-verbalin e pjesëmarrjes në kongres më 13 shkurt 1920.

Idhomen Kosturi propozoi që qeveria të betohej para kongresit. Sotir Peci propozoi që Këshilli i Naltë të betohej para kongresit dhe kabineti të betohej para Këshillit të Naltë. Aqif Pashë Elbasani propozoi që edhe delegatët e kongresit të betoheshin para Këshillit të Naltë. Ilias Vrioni propozoi që para se të bëhej betimi, të emëroheshin zëvendësuesit e ministrave që mungonin, deri sa ata të ktheheshin. Propozimin e zëvendësuesve ta bënte Këshilli i Naltë, e miratimi të bëhej nga mbledhja kombëtare. Me marrëveshje u pranua kryeministër Sulejman Delvina, si njeri që mbante ekuilibrat. Ministër i Punëve të Brendshme Ahmet Zogu, Ministër i Punëve të Jashtme Mehmet Konica, Ministër i Arsimit Sotir Peci, Ministër i Drejtësisë Hoxhë Kadria. Këshilli i Naltë propozoi zëvendës të Hoxhë Kadrisë, Hysen Bej Vrionin dhe zëvendës të Ndoc Çobës, Idhomen Kosturin. Kryeministrin do e zëvendësonte Eshref Frashëri.

Zgjedhja e pushtetit legjislativ/Këshillit të Kombit u bë më 31 janar pasi u kryen betimet. Sotir Peci u kërkoi delegatëve të propozonin anëtarët e pushtetit legjislativ. Komisioni i Mandateve propozoi që Senati të ishte me 37 anëtarë dhe delegatët do propozonin emrat sipas prefekturave. Gjirokastra kishte 4 senatorë, Beqir Bej Rusi, Kiço Koçi, Dhimitër Kacimbra dhe Neki Ruli. Korça me 4 senatorë, Qani Bej Dëshnica, Sejfi Vllamasi, Kostaq Kosta, Thimi Çikozi. Durrësi me Myslym Efendi, Tirana, Ymer Bej Shipku, Irfan Bej Ohri dhe Veli Krrabja. Prefektura e Drinit me Dine Dema, Dine Bej Mashlari, Ramiz Daci dhe Osman Mustafa/Lita. Vlora me Qazim Koculi, Spiro Koleka, Sadullah Tepelena dhe të katërtin do e propozonte prefektura. Elbasani kishte Shefqet

Vërlacin, Arqimandrit Visarion Xhuvani, Adem Peqini dhe Qazim Dyrmishi. Mat, Has, Krasniqe kishte Abdyrrahman Krajli, Ibrahim Bej Çela dhe Bajram Çunin. Shkodra do kishte 4 senatorë dhe Lezha do kishte 2 senatorë, por nuk u caktuan, se nuk ishin delegatët dhe ata do i caktonin prefekturat.

Në fillim organi legjislativ i themeluar nga Kongresi i Lushnjës u emërtua Këshilli i Kombit dhe u mbledh në Tiranë, më 26 mars 1920. Mbledhjen e parë e hapi kryetari i Këshillit të Naltë Aqif Pashë Elbasani. Në fjalën e tij përschëndetëse ai artikuloi se “*Jemi shumë fatbardhë në çeljen e të parit parlament kombëtar. Kur u shpall vetëqeverimi i Shqypnisë, më 28 nëntor 1912, në Vlonë ishte vendos mbledhja e një senati, por nuk u mbledh. Nuk u mbledh as në Kuvendin e Durrësit më 1918*”.

Këshilli i Kombit zgjodhi kryetar gjyqtarin, Xhemal Naipi, nënkryetar Spiro Koleka dhe sekretar Hil Mosin. Pas shtatë ditësh, më 2 prill 1920, Këshilli i Kombit vendosi ta ndryshonte emërtimin e tij si organ përfaqësues e ligjvënës dhe u emërtua Këshilli Kombëtar, dhe përfaqësuesit e zgjedhur nga delegatët e Kongresit të Lushnjës u quajtën këshilltarët e kombit. Më 9 prill 1920, Këshilli Kombëtar miratoi ligjin “Mbi të drejtat e veçanta të këshilltarëve të kombit për faje të ndryshme”, ose “Ligja ndëshkimore për faje politike”. Me atë ligj Këshilli Kombëtar zgjidhi çështjen e imunitetit dhe të paprekshmërisë së deputetëve.

Këshilli Kombëtar, duke u bazuar në normat juridike me fuqi kushtetuese, te Bazat e Kanunores së Këshillit të Naltë, kishte kompetencë të shkarkonte dhe emëronte anëtarët e Këshillit të Naltë dhe të miratonte ndryshimet në qeveri.

Edhe Këshilli Kombëtar ishte model *sui generis* dhe ushtroi *de facto* kompetenca të Kuvendit Kombëtar, sepse bëri ndryshime e plotësime të Bazave të Kanunores së Këshillit të Naltë, duke krijuar Statutin e Zgjeruar të Lushnjës. Me Statutin e Zgjeruar të Lushnjës, i cili u miratua më 22 dhjetor 1922, pushteti legjislativ u emërtua parlament.

Pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve në shtator 1920 dhe vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në vitin 1921 ishin pasoja direkte të stabilizimit të brendshëm që nisi me Kongresin e Lushnjës.

Kongresi i Lushnjës mbetet një nga shembujt më të qartë se si vullneti kombëtar, i organizuar politikisht dhe i mbështetur nga vendosmëria shtetërore, mund të përballojë edhe rreziqe shumë më të mëdha se vetvetja. Ai dëshmoi se shteti shqiptar nuk u ruajt vetëm nga diplomacia ndërkombëtare, por mbi të gjitha nga ndërgjegjja kombëtare, uniteti dhe guximi për të vepruar.

Në historinë e Shqipërisë, Kongresi i Lushnjës nuk është thjesht një kapitull, ai është momenti kur kombi shqiptar vendosi të mbijetojë si shtet sovran.

PA DOGANA, PA VONESA: Europa diskuton “Shengenin ushtarak”



KOLONEL (R) ARBEN DHULI

“Shengeni ushtarak”: Kur lëvizja e lirë nuk vlen vetëm për qytetarët, por edhe për trupat dhe mjetet

Europa po diskuton seriozisht një ide që deri pak vite më parë do të tingëllonte më shumë si koncept teorik sesa si projekt konkret: krijimin e një “Shengeni ushtarak”. Në thelb, është përpjekja për t’i hequr pengesat e brendshme që e ngadalësojnë lëvizjen e forcave dhe pajisjeve ushtarake brenda Bashkimit Evropian një analogji e qartë me zonën *Schengen*, ku njerëzit qarkullojnë pa kontrolle kufitare. Ky debat vjen si përgjigje ndaj tensioneve në krahun lindor të BE-së/NATO-s dhe luftës në Ukrainë, të cilat e kanë kthyer çështjen e reagimit të shpejtë ushtarak në një provë reale sigurie. Por “Shengeni ushtarak” nuk është thjesht një slogan. Ai lidhet me vendimmarrje politike, rregulla të reja administrative, investime të mëdha infrastrukturore dhe mbi të gjitha me një pyetje bazë: a mundet Europa të mbrohet shpejt, nëse kriza kërkon lëvizje të menjëhershme të trupave?

Çfarë nënkupton realisht “Shengeni ushtarak”?

Në përkufizimin praktik të tij, ky koncept synon dy gjëra:

1. Heqjen/harmonizimin e pengesave burokratike që sot e bëjnë transportin ushtarak një proces të ngadaltë, siç janë procedurat doganore, leje të veçanta kombëtare, rregulla të ndryshme nga një shtet te tjetri.

2. Lëvizje ndërkuftare pa vonesa, pra që forcat ushtarake të kalojnë nga një shtet anëtar në tjetrin me një ritëm dhe logjikë operationale jo me ritmin e dosjeve dhe autorizimeve (burokracive të tepruara).

Pra, Parlamenti Evropian kërkon madje përsheptim përmes **zgjidhjeve dixhitale** dhe “qendrave të vetme” (një “one-stop shop”) për autorizimet ndërkuftare.

• Pse është kthyer tani në prioritet?

Në kohë normale, vonesat administrative mund të duken thjesht si bezdi. Në kohë krize, ato kthehen në rrezik sigurie.

Nisur nga kjo, eurodeputetët pranojnë se, pavarësisht përparimit, **ende ka pengesa administrative, financiare dhe infrastrukturore**, deri në atë pikë sa “në disa raste duhet më shumë se një muaj për të lëvizur pajisjet ushtarake brenda BE-së”.

Ky është thelbi i problemit pasi nëse kërcënimi kërkon reagim brenda një afati kohor prej orësh apo ditësh, një sistem që lëviz pajisjet brenda javësh ose edhe muajsh nuk është sistem mbrojtjeje, por kthehet në një mekanizëm vonese.

Kur flitet për “Shengen ushtarak”, shumica mendon për leje dhe vula. Por një pjesë e madhe e këtij projekti është pjesëmarrje **fizike** pra infrastrukture siç janë ura, tunele, rrugë dhe hekurudha. Nëse një urë nuk mban peshën e mjeteve të rënda, ose një tunel nuk ka lartësinë e nevojshme, nuk ka rëndësi sa e thjeshton procedurën doganore kur mjeti nuk mundet të kalojë.

Nisur nga ky kufizim kërkohet modernizim i **hekurudhave, rrugëve, tuneleve dhe urave** dhe



përshtatja e tyre për peshën/dimensionet e mjeteve të rënda, si dhe integrimi i planifikimit civil-ushtarak të transportit. Kjo sjell dy pasoja të rëndësishme:

- **Standardizim teknik** mes vendeve (kapacitet

mbajtës, dimensione, kthesa, gjerësi, lartësi).

- **Infrastrukturë “dual-use”** e ndërtuar për nevoja ushtarake, por që përmirëson edhe qarkullimin civil (transport, tregti, lidhje rajonale).

Në këtë pikë, “Shengeni ushtarak” shndërrohet në një projekt zhvillimi, jo vetëm në një projekt sigurie. Por duke marrë në konsideratë që këto projekte kanë lidhje edhe me koston e këtyre projekteve Parlamenti Evropian mirëpret rritjen e buxhetit për lëvizshmërinë ushtarake në më shumë se 17 miliardë euro në kuadrin e ardhshëm afatgjatë. Vetëm për përmirësimin e rreth 500 “fytëve të ngushta” infrastrukturore (ura, tunele etj.) vlerësohet nevoja për të paktën 100 miliardë euro. Pra duket qartë që një ndër çështjet që vështirësohet është kostoja financiare pra nuk është rregullore që miratohet dhe mbaron por është një proces i gjatë, ku beteja kryesore është financimi dhe prioritetizimi.

• Mesazhi politik: “jo militarizim”, por gatishmëri

Një kundërshtim i zakonshëm në opinionin publik është frika se kjo nismë do ta “militarizojë” BE-në. Por mesazhi politik që përcillet është se nuk synohet militarizim i BE-së, por **rritje e gatishmërisë dhe mbrojtjes kolektive**, si dhe forcim i rolit të BE-së si aktor i sigurisë në koordinim me NATO-n. Në fakt **BE-NATO** në qendër të sajë e sheh lëvizshmërinë ushtarake si një përparësi për bashkëpunimin BE-NATO dhe esenciale për lëvizjen e forcave aleate në paqe, krizë apo luftë. Pra, “Shengeni ushtarak” është edhe një deklaratë politike ku Europa po përpaket të jetë më pak e varur nga improvizimi dhe më shumë e aftë të reagojë si bllok.

• Por çfarë sfidash hap kjo nismë?





Exercise Steadfast Defender 2021 is NATO's flagship exercise for the year and is the first of a new series of long-planned NATO exercises to ensure that our forces are trained, able to operate together and ready to respond to any threat from any direction

RAPID REACTION

REINFORCEMENT BY SEA

REINFORCEMENT BY LAND



REINFORCEMENT BY SEA

SECURING THE ATLANTIC TO ENABLE EUROPEAN REINFORCEMENT BY NORTH AMERICAN ALLIES



REINFORCEMENT BY LAND

COMMAND POST EXERCISE LED BY JSEC IN ULM, GERMANY



RAPID REACTION

THE VERY HIGH READINESS JOINT TASK FORCE DEPLOYS TO ROMANIA

OVER 9,000 PARTICIPANTS

NEARLY 650 PIECES OF EQUIPMENT

MORE THAN 20 PARTICIPATING NATIONS



<https://shape.nato.int/steadfast-defender>

#SteadfastDefender21

Edhe kur ideja duket logjike, zbatimi prek nerva të ndjeshëm si:

- 1) **Sovraniteti dhe kontrolli kombëtar**
Shtetet hezitojnë të heqin dorë nga kontrolli i plotë mbi autorizimet e lëvizjeve ushtarake. “Harmonizimi” kërkon besim të lartë dhe besimi në Europë shpesh ecën më ngadalë se hekurudhat.
- 2) **Transparenca dhe perceptimi publik**
Çdo investim “dual-use” do të shoqërohet me debate: a po bëjmë rrugë për zhvillim ekonomik, apo po ndërtojmë korridore ushtarake? Në shoqëri të polarizuara, narrativa mund të rrëshqasë shpejt.
- 3) **Pabarazia infrastrukture**
Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore shpesh janë në vijën e parë të kërcënimit, por jo gjithmonë kanë infrastrukturën më të përshtatshme. Kjo krijon presion për fonde, por edhe debat mbi shpërndarjen e tyre.
- 4) **“Burokracia e re”**
Ironia e madhe: një projekt që synon të heqë pengesat mund të prodhojë sisteme të reja autorizimi, standardizimi dhe kontrolli. Prandaj insistimi për “qendra të vetme” dhe dixhitalizim është kritik.

• **Ballkani Perëndimor: Korridor strategjik, jo thjesht periferi**
Duke ecur në retrospektivë dhe njëkohësisht hap

pas hapi kjo nisëm ka pasoja edhe për Ballkanin Perëndimor, sepse rajoni shihet gjithnjë e më shumë si pjesë funksionale e arkitekturës evropiane të sigurisë edhe pa qenë ende plotësisht i integruar në BE. Argumenti është i qartë: Ballkani është **urë lidhëse** mes Evropës Qendrore dhe Mesdheut Lindor dhe mund të shërbejë si zonë tranziti drejt krahut juglindor të Evropës. Kjo e nxjerr rajonin nga statusi “problematic periferik” dhe e vendos në një rol “korridor” që sjell mundësi, por edhe përgjegjësi. Edhe vendi ynë Shqipëria ndryshon qasjen e saj strategjike duke u kthyer nga një vend pritës i sigurisë, në njëje logjistike. Pasi Shqipëria del me një profil të veçantë për disa arsye të drejtpërdrejta duke e cilësuar si anëtare e NATO-s, ndodhet në Adriatik dhe ka porte/aeroporte/korridore rrugore që mund të përdoren për logjistikë. Pra edhe në interpretimin praktik që jepet është se Shqipëria mund të shndërrohet në pikë mbështetëse logjistike për operacionet e NATO-s dhe BE-së, gjë e cila rrit rëndësinë e infrastrukturës kombëtare (porte, rrugë, ura, hekurudha) dhe forcon bashkëpunimin me BE-në edhe para anëtarësimit. Pra e thënë ndryshe mundësitë që janë për Investime në infrastrukturë “dual-use”: rrugë/ura/hekurudha më të forta e më moderne, që i shërbejnë ekonomisë po aq sa sigurisë. Rritje e standardeve të logjistikës dhe sigurisë: kur standardet

“Shengeni ushtarak” shndërrohet në një projekt zhvillimi, jo vetëm në një projekt sigurie. Por duke marrë në konsideratë që këto projekte kanë lidhje edhe me koston e këtyre projekteve Parlamenti European mirëpret rritjen e buxhetit për lëvizshmërinë ushtarake në më shumë se 17 miliardë euro në kuadrin e ardhshëm afatgjatë.

ngrihen për kërkesa ushtarake, zakonisht fiton edhe transporti civil. Peshë më e madhe gjeostrategjike: kur je njëje, nuk je thjesht “shtet i vogël”. Gjithashtu nuk mund të mos konsiderojmë edhe rreziqet dhe dilemat ku mund të veçojmë **Menaxhim i kujdesshëm i sigurisë**: nyjat logjistike kërkojnë standarde të larta sigurie, mbrojtje kibernetike, koordinim ndërinstitutional. **Balancë rajonale**: Ballkani është rajon ku aktorët e jashtëm testojnë ndikimin; rritja e rolit të Shqipërisë e ul hapësirën për paqartësi, por rrit nevojën për diplomaci të mençur.

• **Pse “mobiliteti” nuk është fjalë teknike, por strategjike**

Duke marrë në konsideratë se pas luftës në Ukrainë, rezulton se lëvizshmëria ushtarake është rikthyer “në plan të parë” si nevojë urgjente për lëvizje të shpejtë ndërkufitare të trupave/pajisjeve/burimeve në gjithë Europën. Ndaj, mobiliteti nuk është vetëm logjistikë. Është **parandalim** është aftësia për të treguar se, nëse një kërcënim shfaqet, përgjigjja nuk ngec në sportele. Kjo lidhet edhe me “shenjëzimin ushtarak” (military signaling), ku lëvizjet e dukshme, stërvitjet ndërkufitare dhe gatishmëria dërgojnë mesazh parandalues ndaj agresorëve dhe rrisin besueshmërinë e mbrojtjes kolektive.

• **Shembull ilustrues: Steadfast Defender 2021 si “provë e gatishmërisë”**

Si një shembull ilustrues është stërvitja “**Steadfast Defender 2021**” (STD-21), ku NATO testoi gatishmërinë, reagimin e shpejtë dhe aftësinë e komandimit strategjik në kushte krize. Pse është e rëndësishme kjo për debatin e “Shengenit ushtarak”? Sepse stërvitje të tilla tregojnë se, në praktikë, reagimi nuk varet vetëm nga vendimi politik “po lëvizim”, por edhe nga zinxhiri i komandimit, koordinimi shumëkombësh dhe logjistika. Në retrospektivë theksohet se STD-21 ishte kryesisht një **Command Post Exercise (CPX)** dhe testoi elementë si mobiliteti ushtarak, ndërveprueshmëria dhe menaxhimi i krizave nën presion kohor. Me fjalë të thjeshta nëse Europa dhe NATO duan të reagojnë shpejt, duhet të kenë edhe “rrugën”, edhe “rregullin”, edhe “komandën” të sinkronizuara.

• **Përfundim: Një Europë që kërkon të lëvizë më shpejt se kërcënimi**

“Shengeni ushtarak” është një ide që e thjeshton veten në një fjalë: **të lëvizin forcat dhe pajisjet pa vonesa brenda Europës**. Por kur zbërthehet, del se është një projekt i madh transformimi: administrativ (leje, procedura, dixhitalizim), financiar (nga 17 miliardë te nevoja që mund të shkojë në dhjetëra miliarda më shumë) dhe inxhinierik (ura, tunele, hekurudha, korridore). Për Ballkanin dhe Shqipërinë, ky projekt është sinjal se rajoni po shihet jo vetëm si “zonë pritjeje” e integritetit, por si element funksional i sigurisë euro-atlantike me rol, investime potenciale dhe pritshmëri më të larta. Në fund, dilema nuk është nëse Europa po bëhet “më ushtarake” nga dëshira, por nëse po bëhet “më e aftë” nga nevoja të mos e humbasë kohën në kufijtë e brendshëm kur koha është një ndër faktorët që vendos mes parandalimit dhe përshkallëzimit të krizës.

Rreziku i fshehur në plastikë: Lidhja mes ftalatëve dhe sëmundjeve të zemrës

Një alarm i ri për shëndetin publik

Një studim i fundit ka tronditur komunitetin shkencor dhe publikun e gjerë, duke nxjerrë në pah një lidhje të fortë mes përdorimit të përditshëm të plastikës dhe rritjes së vdekjeve nga sëmundjet e zemrës. Sipas ekspertëve, ekspozimi i vazhdueshëm ndaj ftalatëve, kimikate që përdoren për ta bërë plastikën më fleksibël dhe më të qëndrueshme, mund të jetë një faktor i rëndësishëm në shfaqjen e problemeve kardiovaskulare. Vlerësimet tregojnë se rreth 14% e vdekjeve nga sëmundjet e zemrës tek personat e moshës 55–64 vjeç lidhen drejtpërdrejt me kontaktin e përditshëm me këto substanca. Ky zbulim është cilësuar si “shokues”, sepse tregon se një material i zakonshëm, që gjendet në çdo shtëpi, mund të ketë pasoja fatale për shëndetin.



Çfarë janë ftalatët dhe ku gjenden?

Ftalatët janë një grup kimikatesh që përdoren gjerësisht në industri për të zbutur plastikën dhe për ta bërë atë më të qëndrueshme ndaj konsumit. Ato gjenden në një gamë të gjerë produktesh që përdorim çdo ditë pa e menduar dy herë. Ambalazhet e ushqimeve, shishet plastike, lodrat e fëmijëve, produktet kozmetike si parfumet dhe kremrat, madje edhe pajisjet mjekësore, përmbajnë ftalatë. Kjo do të thotë se ekspozimi është pothuajse i pashmangshëm: nga ushqimi që konsumojmë, tek produktet që vendosim mbi lëkurë, e deri tek mjedisi ku jetojmë. Për shkak të përdorimit masiv, ftalatët janë bërë pjesë e pandashme e jetës moderne, por ky komoditet ka një kosto të fshehur që po del në dritë.

Si ndikojnë ftalatët në organizëm?

Shkencëtarët i kanë klasifikuar ftalatët si ndërhyrës endokrinë, pra substanca që prishin ekuilibrin hormonal të trupit. Hormonet janë thelbësore për funksionimin normal të organizmit, dhe çdo ndërhyrje në to mund të shkaktojë pasoja të gjera. Studimet tregojnë se ekspozimi afatgjatë ndaj ftalatëve lidhet me rritjen e rrezikut për hipertension, arteriosklerozë dhe infarkt. Përveç sistemit kardiovaskular, ftalatët ndikojnë edhe në sistemin riprodhues, duke shkaktuar probleme me fertilitetin tek burrat dhe gratë. Ka gjithashtu prova që sugjerojnë lidhje me obezitetin dhe diabetin, duke e bërë këtë grup kimikatesh një kërcënim të shumëfishtë për shëndetin publik.

Pse ky zbulim është kaq i rëndësishëm?

Ky studim është i rëndësishëm sepse për herë të parë është bërë një lidhje e qartë mes përdorimit të plastikës dhe vdekshmërisë nga sëmundjet e zemrës. Deri më tani, plastika shihej kryesisht si një problem mjedisor, për shkak të ndotjes që shkakton. Por tani, ajo po del të jetë edhe një problem i drejtpërdrejtë shëndetësor. Nëse një material kaq i zakonshëm mund të kontribuojë në



vdekjet kardiovaskulare, atëherë kemi të bëjmë me një krizë të re shëndetësore që kërkon vëmendje urgjente. Ekspertët paralajmërojnë se nëse nuk ndërmerren masa, brezat e ardhshëm do të përballen me pasoja edhe më të rënda.

Çfarë mund të bëjmë për ta kufizuar rrezikun?

Zgjidhjet nuk janë të thjeshta, por disa hapa mund të ndihmojnë. Konsumatorët mund të zgjedhin produkte pa ftalatë, duke lexuar me kujdes etiketat. Kompanitë duhet të jenë më transparente dhe të ofrojnë alternativa më të sigurta. Politikat publike duhet të forcohen, duke vendosur kufizime më të rrepta për përdorimin e kimikateve të rrezikshme. Përveç kësaj, edukimi i publikut është thelbësor: njerëzit duhet të kuptojnë se zgjedhjet e tyre të përditshme, si përdorimi i shisheve plastike apo blerja e produkteve kozmetike, mund të kenë ndikim afatgjatë në shëndetin e tyre.

Zëri i ekspertëve

Dr. Trasande ka theksuar:

“Ky është një alarm për shëndetin publik. Duhet të rishikojmë mënyrën se si prodhojmë dhe përdorim plastikën, përndryshe do të përballemi me pasoja të rënda për brezat e ardhshëm”.

Ky mesazh është një thirrje për veprim, jo vetëm për individët, por edhe për qeveritë dhe industrinë. Shëndeti publik nuk mund të mbrohet pa një bashkëpunim të gjerë dhe pa ndërgjegjësim kolektiv. Ky studim na kujton se plastika nuk është thjesht një material i dobishëm dhe i lirë, por edhe një rrezik i fshehur për shëndetin. Nëse nuk ndërmerren masa, ftalatët mund të shndërrohen në një nga faktorët kryesorë të vdekshmërisë kardiovaskulare në dekadat e ardhshme. Prandaj, është koha të reflektojmë mbi mënyrën se si jetojmë dhe të kërkojmë alternativa më të sigurta për të mbrojtur shëndetin tonë dhe të brezave që do të vijnë.



Algoritmet e inteligjencës artificiale për vendimmarrje taktike në kohë reale

Inteligjenca artificiale po hyn me ritme të shpejta në fushën e teknologjisë ushtarake, duke ndryshuar mënyrën se si konceptohet dhe zhvillohet lufta. Në një botë ku informacioni është i pafund dhe ku çdo sekondë mund të përcaktojë fatin e një beteje, aftësia për të marrë vendime të menjëhershme është bërë jetike. Algoritmet e inteligjencës artificiale, të ndërtuara mbi bazën e mësimit të makinerive dhe analizës së të dhënave masive, po shndërrohen në mjetet kryesore që komandat ushtarake përdorin për të fituar avantazh strategjik. Ky transformim nuk është thjesht teknologjik, por ka edhe dimensione të thella politike, etike dhe filozofike, pasi vendimet e marra nga makineritë mund të ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e mijëra njerëzve.

Kur sekondat vendosin fatin e betejës

Vendimmarrja taktike në kohë reale nënkupton aftësinë për të analizuar situata komplekse dhe për të sugjeruar veprime të menjëhershme. Në fushën e betejës, ku çdo lëvizje duhet të jetë e shpejtë dhe e saktë, algoritmet e inteligjencës artificiale janë të afta të përpunojnë miliona të dhëna që vijnë nga satelitët, dronët, radarët dhe sensorët tokësorë. Ato mund të identifikojnë modele të fshehura, të parashikojnë lëvizjet e armikut dhe të sugjerojnë veprime konkrete, si zhvendosja e trupave, aktivizimi i mbrojtjes ajrore apo neutralizimi i një kërcënimi. Ky proces ndodh brenda sekondave, duke i dhënë komandantëve një avantazh që më parë ishte i paimagjinueshëm.

Dronët që vendosin vetë dhe mbrojtja ajrore inteligjente

Shembujt e përdorimit të algoritmeve të inteligjencës artificiale janë të shumtë dhe po shtohen çdo ditë. Dronët autonomë nuk janë më thjesht mjete të komanduara nga distanca, por sisteme që marrin vendime vetë, duke zgjedhur objektivat ose duke shmangur raketat kundërajrore pa ndërhyrje njerëzore. Në sistemet e mbrojtjes ajrore, inteligjenca artificiale është në gjendje të dallojë brenda sekondave nëse një objekt fluturues është raketë, avion mik apo dron armik, duke aktivizuar menjëherë kundërmasat. Edhe në operacionet tokësore, algoritmet analizojnë lëvizjet e armikut dhe sugjerojnë pozicionimin optimal të trupave për të shmangur rrethimin ose për të fituar terren strategjik.

Gjeneralët digjitalë: Si mësojnë makineritë

Në bazë të këtyre sistemeve qëndrojnë teknika të avancuara si mësimi i makinerive, ku sistemet mësojnë nga të dhënat e kaluara për të parashikuar sjelljen e armikut, dhe mësimi i thellë, ku rrjetet nervore artificiale analizojnë imazhe satelitore, video nga dronët dhe sinjale radarike për të identifikuar kërcënime. Algoritmet prediktive parashikojnë lëvizjet e armikut, duke u bazuar në modelet historike të sjelljes, ndërsa sistemet e optimizimit në kohë reale sugjerojnë veprime të menjëhershme, duke balancuar rrezikun dhe përfitimin. Kjo e bën inteligjencën artificiale një mjet jo vetëm të shpejtë, por edhe të sofistikuar.

Avantazhi strategjik i shteteve që zotërojnë AI

Ndikimi strategjik i këtyre algoritmeve është i jashtëzakonshëm. Vendimet merren më shpejt se kurrë më parë, duke reduktuar humbjet njerëzore dhe duke rritur efikasitetin e operacioneve. Shtetet që zotërojnë inteligjencë artificiale të avancuar fitojnë një avantazh të madh strategjik ndaj rivalëve, pasi mund të parandalojnë gabimet që shpesh ndodhin nga lodhja ose presioni psikologjik tek komandantët. Në këtë mënyrë, teknologjia nuk është thjesht një mjet ndihmës, por një



Inteligjenca Artificiale (IA) është aftësia e sistemeve kompjuterike për të kryer detyra që zakonisht kërkojnë mendje njerëzore, si të mësuarit, arsyetimi, marrja e vendimeve dhe zgjidhja e problemeve. Ajo përdor algoritme dhe modele të avancuara për të analizuar të dhëna, për të njohur modele dhe për të vepruar në mënyrë të pavarur. IA është sot pjesë e jetës sonë të përditshme, nga telefonat inteligjentë e deri te mjetet e automatizuara në industri, mjekësi dhe komunikim.

Algoritmet e inteligjencës artificiale, të ndërtuara mbi bazën e mësimit të makinerive dhe analizës së të dhënave masive, po shndërrohen në mjetet kryesore që komandat ushtarake përdorin për të fituar avantazh strategjik. Ky transformim nuk është thjesht teknologjik, por ka edhe dimensione të thella politike, etike dhe filozofike, pasi vendimet e marra nga makineritë mund të ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e mijëra njerëzve.

faktor vendimtar në fushën e betejës.

Dilemat etike dhe rreziqet e algoritmeve të padukshme

Megjithatë, përdorimi i inteligjencës artificiale sjell edhe sfida të mëdha dhe dilema etike. Një nga pyetjet më të mëdha është: a duhet t'i lejohej një makinerie të vendosë për jetën dhe vdekjen? Vendimet pa ndërhyrje njerëzore ngrenë shqetësime të thella morale, pasi përgjegjësia për pasojat bëhet e paqartë. Ekziston gjithashtu rreziku i manipulimit, ku algoritmet mund të keqpërdoren ose të sulmohen nga hakerë, duke sjellë pasoja katastrofike. Transparenca është një tjetër problem, pasi shumë algoritme funksionojnë si "kuti të zeza", pa e ditur saktësisht si arrijnë në një vendim.

E ardhmja e luftës: Algoritmet si komandantë

E ardhmja e inteligjencës artificiale në fushën e betejës duket e pashmangshme. Ekspertët parashikojnë se në dekadat e ardhshme, AI-ja do të bëhet pjesë e çdo sistemi ushtarak, nga tanket tek flotat detare. Koordinimi ndërmjet trupave njerëzore dhe sistemeve autonome pritet të bëhet standard, ndërsa konfliktet e ardhshme mund të vendosen jo nga gjeneralët, por nga algoritmet. Kjo hap një kapitull të ri në historinë e luftës, ku teknologjia dhe etika do të përplasen vazhdimisht.

Algoritmet e inteligjencës artificiale për vendimmarrje taktike në kohë reale po ndryshojnë rrënjësisht mënyrën se si konceptohet lufta. Ato ofrojnë shpejtësi, efikasitet dhe avantazh strategjik, por njëkohësisht hapin dilema

të mëdha etike dhe politike. Në një botë ku teknologjia po ecën më shpejt se diplomacia, pyetja mbetet e hapur: kush do të kontrollojë algoritmet që vendosin për fatin e njerëzimit?

Shembuj historikë dhe aktualë: AI-ja në fushën e betejës

Përdorimi i inteligjencës artificiale nuk është më thjesht një koncept teorik, por një realitet i dokumentuar në disa konflikte të viteve të fundit. Lufta Rusi-Ukrainë ka treguar qartë rolin e AI-së në menaxhimin e dronëve dhe sistemeve të mbrojtjes ajrore. Ukraina ka përdorur algoritme për të analizuar trajektoret e raketave dhe për të aktivizuar kundërmasa më shpejt se sa mund ta bënte një operator njerëzor, duke shpëtuar jetë dhe duke rritur efikasitetin e mbrojtjes. Nga ana tjetër, Rusia ka eksperimentuar me sisteme të automatizuara për koordinimin e sulmeve me dronë kamikazë, duke treguar se AI-ja është bërë pjesë e arsenalit të saj taktik.

Edhe ushtria amerikane ka përdorur inteligjencën artificiale në operacionet e saj në Lindjen e Mesme, veçanërisht për analizimin e imazheve satelitore dhe identifikimin e bazave të grupeve militante. Algoritmet kanë mësuar të dallojnë objekte të vogla, si automjete të fshehura nën mbulesa, duke i dhënë komandantëve një pasqyrë më të qartë të terrenit dhe duke lehtësuar marrjen e vendimeve të shpejta. Këto shembuj tregojnë se AI-ja nuk është më një teknologji e së ardhmes, por një mjet i tashmë i integruar në fushën e betejës, i cili po ndryshon mënyrën se si zhvillohen konfliktet moderne.



BËHU PJESË E FORCËS REZERVISTE!

Ligji për Forcën Rezerviste ka hyrë në fazën e implementimit.

Çdo shtetas që plotëson kriteret ligjore ka të drejtë të aplikojë për t'u bërë pjesë e **Forcës Rezerviste të Forcave të Armatosura**, duke kontribuar drejtpërdrejt në mbrojtjen dhe sigurinë e vendit.

Forca Rezerviste garanton **mobilizim të shpejtë dhe efektiv** në raste krizash, emergjencash apo nevojash të veçanta kombëtare, duke ofruar një **balancë të qëndrueshme mes jetës civile dhe angazhimit ushtarak**.

□ **Kush mund të aplikojë?**

Çdo shtetas që përmbush kriteret e përcaktuara me ligj.

□ **Ku të informoheni?**

➔ Faqja zyrtare e Ministrisë së Mbrojtjes: www.mod.gov.al

➔ **Qendra e Rekrutimit**

□ Tel: **00355 4 234 8588**

□ WhatsApp: **+355 68 340 4896**

Forca Rezerviste, shërbe sot për sigurinë e së nesërmes.

Kontribuo për atdheun. Bëhu pjesë e Forcave të Armatosura.